



*Shkarkimi i
regjistrimeve të
njësura nga baza e të
dhënave LC/NAF*



United Nations
Educational, Scientific and
Cultural Organization

Regional Centre for
Library Information Systems and
Current Research Information Systems
Regionalni center za knjižnične
informacijske sisteme in informacijske
sisteme o raziskovalni dejavnosti

IZUM

© IZUM, 2025

IZUM, COBISS, COMARC, COBIB, COLIB, CONOR, SICRIS, E-CRIS janë marka të regjistruara në pronësi të institucionit publik IZUM.

PËRMBAJTJA

1	Informacionet kryesore	1
2	Informacionet e përgjithshme rreth shkarkimit të regjistrimeve nga baza e të dhënave LC/NAF	1
	Procedurat fillestare të shkarkimit	1
	Konvertimi i regjistrimit original LC/NAF	2
	Kërkimi në LC/NAF	2
	Gjuha e katalogimit	4
	Shenjat e pikësimit	4
	Transliterimi apo transkriptimi	4
3	Regjistrimi pas konvertimit – karakteristikat sipas fushave/nënfushave të veçanta	4
	Statusi i regjistrimit (nënfusha 001a)	4
	Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrave (ISNI) (fusha 010)	4
	Numrat e kontrollit të regjistrimeve nga sistemet e tjera (fusha 035)	5
	Statusi i pikëqasjes së njësuar (nënfusha 100b)	5
	Përdorimi i pikëqasjes si emërtim lëndor (fusha 106)	5
	Emër vetjak i diferencuar ose i padiferencuar (nënfusha 120b)	6
	Pikëqasja e njësuar (fusha 2XX)	6
	Shënimi informues (fusha 300) dhe shënimi për biografi dhe veprimtari (fusha 340)	7
	Varianti i pikëqasjes (fusha 4XX)	7
	Pikëqasja në lidhshmëri – emër vetjak (fusha 500)	8
	Pikëqasja në lidhshmëri – emër organizate (fusha 510)	8
	E dhëna është në (fusha 810)	8
	E dhëna nuk është në (fusha 815)	9
	Shënime të përgjithshme të kataloguesit (fusha 830)	9

1 Informacionet kryesore

Në COBISS mund të shkarkoni regjistrimet e njësuar nga baza e të dhënave LC/NAF.

LC/NAF – Library of Congress/NACO Authority File¹ është një bazë e gjerë e emrave, kontribut i bibliotekave që bashkëpunojnë në programin NACO (Name Authority Cooperative Program) të programit ndërkombëtar për katalogimin e përbashkët PCC (Program for Cooperative Cataloging), të cilin e bashkërendon Biblioteka e Kongresit (Library of Congress). Baza e të dhënave LC/NAF përmban regjistrime për emrat e personave, organizatave, mbledhjeve dhe njësive politike e territoriale, si dhe regjistrime për titujt uniform, titujt e koleksioneve bibliotekare dhe pikëqasje për emrat/titujt.

Procedura e shkarkimit të regjistrimeve të njësuar nga baza e të dhënave LC/NAF është përshkruar në manualin *Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat*. Në përcaktimin e pikëqasjes mund të konsultoheni me burime të ndryshme, siç është shërbimi VIAF², bazat kombëtare të njësuar, katalogët dhe bibliografite e bibliotekave kombëtare (në disa biblioteka dhe baza të njësuar mund të hyni përmes VIAF-it), internetin, manualët e përgjithshëm (enciklopeditë, leksikonët etj.) etj.

Udhëzimet për shënimin e të dhënave në formatin COMARC janë përshkruar në manualin *Formati COMARC/A*, udhëzimet për punë në program në manualin *Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat*, ndërsa në dispozicion është edhe materiali nga kursi CONOR³.

2 Informacionet e përgjithshme rreth shkarkimit të regjistrimeve nga baza e të dhënave LC/NAF

Procedurat fillestare të shkarkimit

Baza e të dhënave LC/NAF shfaqet në listën për përzgjedhjen e bazës së të dhënave në dritaren për kërkim COBISS Cat, nëse kataloguesi posedon lejen për krijimin dhe redaktimin e regjistrimeve të plota të njësuar për emrat vetjakë dhe shkarkimin e regjistrimeve nga baza e të dhënave LC/NAF (CAT_NEWPN). Me këtë leje kataloguesi në COBISS Cat, në bazën e të dhënave LC/NAF mund të kërkojë me llojet e regjistrimeve të njësuar, mund t'i shfaq ato dhe sipas nevojës t'i transferoj edhe në hapësirën e punës. Ndërsa mund të shkarkoj vetëm regjistrimet për emrat e personave (CAT_NEWPN) dhe organizatave (CAT_NEWCB – krijimi dhe redaktimi i regjistrimeve për organizatat).

Shkarkimi i regjistrimeve nga baza e të dhënave LC/NAF nuk është i detyrueshëm. Para se të vendosni të shkarkoni regjistrimin duhet të shikoni a është regjistrimi në bazën e të dhënave LC/NAF i plotë dhe cilësor. Nëse mendoni se përmirësimi apo plotësimi i regjistrimit do të marr shumë kohë, regjistrimin nuk e shkarkoni por atë e krijoni nga fillimi. Regjistrimi nga baza e të

¹ LC Name Authority File (LCNAF): <http://id.loc.gov/authorities/names.html> (marrë më dt. 10. 6. 2019).

² VIAF: The Virtual International Authority File: <https://viaf.org/> (marrë më dt. 28. 8. 2019).

³ Katalogimi në sistemin COBISS – përditësimi CONOR, Maribor, IZUM.

dhënave LC/NAF ju ndihmon edhe nëse atë vetëm e transferoni në hapësirën, nga ai kopjoni të dhënat dhe ato i transferoni në regjistrimin e ri në redaktues.

Gjatë shkarkimit duhet të keni kujdesë, që të shkarkoni regjistrimin për entitetin e duhur. Nëse e shihni se regjistrimi në bazën LC/NAF nuk përfaqëson entitetin e njëjtë, regjistrimin nuk duhet ta shndërroni në një regjistrim për entitetin tjetër, mirëpo duhet të krijoni regjistrim të ri.

Gjithashtu nuk duhet të shkarkoni regjistrimin për emrin vetjak të padiferencuar⁴ (në angl. *undifferentiated name record*), nëse personin të cilin po e përshkruani mund ta dalloni nga personat e tjerë me emrin e njëjtë.

Regjistrimin nga baza e të dhënave LC/NAF mund ta shkarkoni vetëm një herë. Nëse dëshironi të shkarkoni regjistrimin, të cilin e keni shkarkuar tashmë, këtë ua pamundëson programi, i cili në bazë të numrit në fushën 035 – *Numrat e kontrollit të regjistrimeve në sistemet e tjera* kontrollon nëse regjistrimi me numrin e njëjtë tashmë ekziston në bazën e të dhënave CONOR.AL.

Në regjistrimin e shkarkuar nga baza e të dhënave LC/NAF, emri i përdoruesit i personit që ka shkarkuar regjistrimin përfundon me vizë poshtë dhe mbaresën LC: <akronimi bazës së njësuar>::<akronimi i bibliotekës_emri i përdoruesit_LC> (p.sh. CONOR::IZUM_BRIGITAF_LC).

Konvertimi i regjistrimit origjinal LC/NAF

Regjistrimi origjinal në bazën e të dhënave LC/NAF është në formatin MARC 21 dhe i krijuar sipas rregullave anglo-amerikane të katalogimit (AACR2, RDA). Gjatë shkarkimit të dhënat në regjistrim shndërrohen (konvertohen) në mënyrë automatike nga formati MARC 21 në formatin COMARC/A, ndërsa maska e të dhënave përcaktohet bazuar në të dhënat e koduara në regjistrim.

Pas konvertimit të dhënat në regjistrim i përmirësoni apo i plotësoni ato në përputhje me rregullat e vlefshme të katalogimit në sistemin COBISS.AL. Shtohen edhe fushat/nënfushat që nuk janë transferuar nga baza e të dhënave LC/NAF. Plotësohen të dhënat e koduara që mungojnë në bllokun 1XX (p.sh. nënfusha 102a – *Kombësia e entitetit*, 150b – *Kodi për konferencë ose mbledhje* etj.) dhe shtohen shënimet në bllokun 3XX dhe 8XX (p.sh. në fushën 820 vendoset shënimi për adashët, nëse në bazën e të dhënave CONOR.AL ekzistojnë disa persona me të njëjtin emër etj.).

Rekomandohet, që regjistrimi të përmirësohet apo plotësohet deri në ata kufij, që të përmbaj të gjitha të dhënat e nevojshme: verifikohet dhe konfirmohet pikëqasja e njësuar, shtohen burimet për pikëqasjen e njësuar dhe për variantet e pikëqasjeve, sipas nevojës fshihen variantet e pikëqasjeve ose/dhe shtohen ato që mungojnë, nëse është e nevojshme regjistrimi plotësohet me pikëqasjet në lidhshmëri, bëhen shënime për përdoruesit në bllokun 3XX, shtohen shënimet për kataloguesit në bllokun 8XX, si dhe plotësohen të gjitha fushat e koduara.

Kërkimi në LC/NAF

Në dritaren për kërkim LC/NAF në COBISS Cat kërkohen emrat personale përmes fushës për kërkim "Emër vetjak", që përfshin përqasjet e njësuara, variantet e pikëqasjeve dhe pikëqasjet në

⁴ Katalogimi në sistemin COBISS – përditësimi CONOR, Maribor, IZUM.

lidhshmëri. Tek "Emër vetjak" shënohet emri vetjak (personal) në formën e përmbysur pa shtesa te emri (p.sh. *Hemingway, Ernest*) ose me shtesa te emri (p.sh. *Hemingway, Ernest, 1899–1961*⁵).

Midis rezultateve të kërimit tek "Emër vetjak" mund të jenë edhe regjistrimet për pikëqasjen emër/titull (p.sh. *Hemingway, Ernest, 1899-1961. Sun also rises*). Nga regjistrimet për emra vetjakë ato i dallon fakti se, pikëqasja e njësuar për emër/titull përbëhet nga emri vetjak dhe titulli i veprës me të cilën është i lidhur ai. Regjistrimet e tilla nuk mund të shkarkohen, mirëpo ato mund të transferohen në kujtesën e fragmenteve dhe të dhënat e nevojshme të kopjohen.

Në dritaren për kërkim LC/NAF kërkohen emrat e organizatave përmes fushës për kërkim "Emër organizate", ndërsa emrat e mbledhjeve kërkohen përmes fushës për kërkim "Emër konference".⁶ Kërkimi me "Emër organizate" dhe "Emër konference" përfshin pikëqasjet e njësuara, variantet e pikëqasjeve dhe pikëqasjet në lidhshmëri. Si pyetje për kërkim mund të shënohet emri i organizatës apo mbledhjes, pa ose me cilësorë.⁷ Kur në pyetjen për kërkim shënohen cilësorët, ata mes vete ndahen përmes hapësirave, në të njëjtën renditje siç janë në regjistrimin në bazën e të dhënave LC/NAF. P.sh. mbledhja *1st Pan American Congress of Pharmacy* e vitit 1948 në Havana, Cuba përmes "Emër konference" mund të kërkohet si *Pan American Congress of Pharmacy* ose me cilësorët *Pan American Congress of Pharmacy 1st 1948 Havana Cuba*. Emrin e organizatës *Institute of Contemporary Art* në Boston, Massachusetts mund ta kërkonit përmes "Emër organizate" si *Institute of Contemporary Art* ose me cilësorët *Institute of Contemporary Art Boston* etj.

Emrat e personave, organizatave dhe mbledhjeve mund të kërkohen edhe përmes fushës për kërkim "Fjalët kyçe", mirëpo në këtë mënyrë programi nuk kërkon vetëm në fushat për pikëqasjet, por edhe në fushat e tjera të regjistrimit. Rezultat i një kërkitimi të tillë mund të jetë një numër i madh i regjistrimeve të gjetura.

Kërkimi mund të kufizohet me fushën për kërkim "Pikëqasja e njësuar", e cila përfshin vetëm pikëqasjet e njësuara për emrat e personave, organizatave, mbledhjeve etj.

Në dritaren për kërkim LC/NAF përmes fushës për kërkim "Numri i kontrollit" mund të kërkonit vetëm numrin e kontrollit të regjistrimit në bazën e të dhënave LC/NAF. Mirëpo, në këtë fushë për kërkim nuk mund të kërkonit numrat e kontrollit të sistemeve të tjera. Në fushën "Numri i kontrollit" shënoni vetëm numrat pa shkronja (p.sh. për (DLC)n 88034828 kërkonit 88034828⁸).

Te rezultatet e kërimit në dritaren për kërkim LC/NAF pikëqasjet shihen në tërësi nëse e zgjeroni kolonën. Nëse dëshironi që kolonën ta zgjeroni më shumë se sa që është e paracaktuar, në parametrat e përdoruesit duhet të zbrazeni fushën e zgjedhjes tek *Gjerësi e kufizuar e kolonës në dritaren për kërkim*.

⁵ Në pyetjen për kërkim presja mund edhe të mos shënohet. Disa terma të veçantë për kërkim ndahen me hapësirë, p.sh. *Hemingway Ernest 1899–1961*.

⁶ Në dritaren për kërkim të bazës së të dhënave CONOR.AL emrat e organizatave dhe mbledhjeve kërkohen në të njëjtën fushë për kërkim "Emër organizate" apo me parashtesën CB= ose prapashtesën /CB.

⁷ Në dritaren për kërkim të bazës së të dhënave CONOR.AL në fushën për kërkim "Emër organizate" dhe te parashtesa CB= pikëqasjen e njësuar duhet ta shënoni bashkë me cilësorët dhe me shenjat e pikësimit të përcaktuara nga ISBD, p.sh. *Congress of Child Neurologists of Mediterranean (17 ; 2011 ; Piran)* ose pyetjen për kërkim duhet ta shkurttoni me simbolin "*", p.sh. *Congress of Child Neurologists of Mediterranean**.

⁸ Në dritaren për kërkim të bazës së të dhënave CONOR.AL mund të kërkonit edhe numrin e kontrollit të regjistrimit në bazën e të dhënave LC/NAF edhe numrin e kontrollit nga sistemet e tjera. Pyetjen për kërkim e shënoni me shkronja dhe me numra ose vetëm me numra, p.sh. LC=88034828 ali LC=(DLC)n 88034828.

Në paraqitësin LC/NAF regjistrimet mund të shfaqen në formatin original MARC 21 ose në formatin COMARC/A.

Gjuha e katalogimit

Në bazën e të dhënave LC/NAF gjuha e katalogimit është anglishtja. Gjatë konvertimit të regjistrimeve në bazën e të dhënave CONOR disa fraza nga anglishtja përkthehen në mënyrë automatike në gjuhën e katalogimit, ndërsa të dhënat e tjera mbeten në anglisht. Këto të dhëna duhet të përkthehen në gjuhën e katalogimit, në rastin tuaj në gjuhën shqipe. Duhet të keni kujdes të veçantë në fushën 340 – *Shënim për biografi dhe veprimtari*.

Shenjat e pikësimit

Në formatin MARC 21 shenjat e pikësimit midis të dhënave i vendos kataloguesi, ndërsa në formatin COMARC/A shumica e shenjave të pikësimit në regjistrim vendosen në mënyrë automatike. Pas konvertimit shenjat e pikësimit fshihen në mënyrë automatike, aty ku kjo është e mundur, ndërsa në raste të tjera këtë duhet ta bëni në mënyrë manuale.

Transliterimi apo transkriptimi

Në bazën e të dhënave LC/NAF për emrat që nuk janë në shkrim latin përdoret transliterimi apo transkriptimi sipas rregullave *ALA-LC Romanization Tables*⁹, të cilat ndryshojnë nga rregullat tona. Pas transferimit të regjistrimeve për emrat në shkrim jolatin duhet të verifikohen dhe të përmirësohen të dhënat e transliteruara në përputhje me rregullat tona për transliterimin apo transkriptimin. Kataloguesi vendos vet, nëse për emrin në shkrim jolatin është më mirë të shkarkoj regjistrimin apo ta krijoj atë nga fillimi.

3 Regjistrimi pas konvertimit – karakteristikat sipas fushave/nënfushave të veçanta

Statusi i regjistrimit (nënfusha 001a)

Kodi "n" – *regjistrim i ri* në nënfushën 001a është vlerë e paracaktuar në çdo regjistrim të shkarkuar. Rekomandohet që regjistrimi të përmirësohet apo plotësohet, më pas në nënfushën 001a të vendoset kodi "c" – *regjistrim i redaktuar*.

Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i Emrave (ISNI) (fusha 010)

Tek disa regjistrime gjatë procesit të konvertimit në fushën 010 transferohet edhe Identifikuesi Standard Ndërkombëtar i emrave (ISNI). Këtë fushë mos e fshini e as mos e redaktoni.

⁹ ALA-LC Romanization Tables: <https://www.loc.gov/catdir/cpsd/roman.html> (marrë më dt. 6. 6. 2019).

Numrat e kontrollit të regjistrimeve nga sistemet e tjera (fusha 035)

Pas konvertimit, në fushën 035 gjithmonë vendoset edhe numri i kontrollit i regjistrimit në bazën e të dhënave LC/NAF. Numri i kontrollit në fushë transferohet bashkë me shkronjat – *DLC* brenda kllapave dhe shkronjën *n* jashtë kllapave (p.sh. *(DLC)n 79063767*). Fusha 035, përmbajtja e së cilës fillon me shkronjat *DLC*¹⁰, nuk duhet të fshihet apo të përmirësohet.

Disa regjistrime në bazën e të dhënave LC/NAF përveç numrit të kontrollit të bazës LC/NAF kanë edhe numrin e kontrollit nga sistemet e tjera, siç është *OCLC*, *UK*, *DNLM* etj. Pas transferimit nga baza LC/NAF numri i kontrollit nga sistemet e tjera transferohet në fushën e përsëritshme 035 (p.sh. *(OCoLC)oca00296711*, *(Uk)005981632*, *(DNLM)1787019* etj.). As këto fusha nuk duhet të fshihen ose të përmirësohen.

Statusi i pikëqasjes së njësuar (nënfusha 100b)

Rekomandohet që pikëqasjen e njësuar në regjistrim të verifikohet mirë, në mënyrë që në nënfushën 100b të mund të vendoset kodi "*a*" – *e pranuar*. Në këtë rast regjistrimet bibliografike bashkërendohen me ato të njësuar. Bashkërendimi automatik është me rëndësi sepse ndryshimet (p.sh. ndryshimet e emrave, shtimi i varianteve të emrave) vazhdimisht respektohen. Për këtë arsye edhe kërkimi është më i mirë dhe më i thjeshtë.

Nëse përmes konvertimit në nënfushën 100b transferohet kodi "*c*" – *e përkohshme*, pikëqasjen e njësuar në fushën 2XX duhet ta verifikoni dhe në përputhje me të dhënat që keni në dispozicion përfundimisht ta plotësoni. Më pas kodin në nënfushën 100b e ndryshoni në "*a*" – *e pranuar*, që do të thotë se pikëqasjen e njësuar e keni konfirmuar (verifikuar).

Nëse pikëqasjet e njësuar nuk mund t'i krijoni të plota për shkak të mungesës së të dhënave, në nënfushën 100b e lini kodin "*c*" – *e përkohshme*.

Përdorimi i pikëqasjes si emërtim lëndor (fusha 106)

Te përzgjedhja e kodit në fushën 106 respektohen rregullat e klasifikimit lëndor. Pas konvertimit verifikohet nëse forma e njësuar e emrit në fushën 2XX është e njëjtë me formën e emrit që përdoret si emërtim lëndor. Nëse format e emrit përputhen, në nënfushën 106a vendoset kodi "*0*" – *mund të përdoret edhe si emërtim lëndor*, mirëpo nëse format e emrit janë të ndryshme, në nënfushën 106a vendoset kodi "*1*" – *nuk mund të përdoret si emërtim lëndor*.¹¹

¹⁰ Fshirja dhe ndryshimi i përmbajtjes së fushës 035, që përmban simbolin *DLC*, nuk mund të bëhen për shkak të kontrollit të programit.

¹¹ Nëse keni vendosur që forma e njësuar e emrit vetjak pa datën e lindjes/vdekjes (nuk është e plotësuar nënfusha 200f – *Datat*) të përdoret edhe si emërtim lëndor (106 = "0"), programi ju sugjeron të verifikoni nëse mungon e dhëna në nënfushën 200f. Kontrolli i programit funksionon edhe anasjelltas, nëse keni vendosur që forma e njësuar e emrit vetjak me datën e lindjes/vdekjes (është plotësuar nënfusha 200f – *Datat*) të mos përdoret si emërtim lëndor (106 = "1"). Kontrolli i programit vetëm ju paralajmëron në ndonjë gabim të mundshëm, që do të thotë se regjistrimin mund ta ruani edhe pse atë nuk e përmirësoni në përputhje me sugjerimet e programit. Sipas rregullave të disa sistemeve për klasifikimin lëndor, emrit vetjak duhet patjetër t'i shtohet data e lindjes/vdekjes si emërtime lëndore.

Emër vetjak i diferencuar ose i padiferencuar (nënfusha 120b)

Nëse regjistrimi në bazën e të dhënave LC/NAF vlenë për emër vetjak të padiferencuar¹² (në angl. *undifferentiated name record*), kjo është për dy ose më shumë persona me emër të njëjtë, kur personat në fushën 200 për shkak të mungesës së të dhënave nuk mund të dallohen nga personat e tjerë me emrin e njëjtë, pas konvertimit në nënfushën 120b transferohet kodi "b" – *emër vetjak i padiferencuar*. Në fushën 830 mund të transferohen (nga fusha 667 e formatit MARC 21) shënimet¹³ që janë relevante për bazën LC/NAF.

Nëse personin nuk mund ta diferenconi nga personat e tjerë me të njëjtin emër, nga baza e të dhënave LC/NAF mund të shkarkoni regjistrimin për emrin vetjak të padiferencuar. Në nënfushën 120b – *Emër vetjak i diferencuar dhe i padiferencuar* mbani kodin "b" – *emër vetjak i padiferencuar*. Shtoni fushën e përsëritshme 810 – *E dhëna është në* me veprën bibliografike, me të cilën keni lidhur regjistrimin e njësuar për emrin vetjak të padiferencuar. Fushën e përsëritni për çdo vepër bibliografike; nëse janë shumë i vendosni së paku tri.

Nëse personin mund ta diferenconi nga personat me të njëjtin emër, regjistrimin për emrin vetjak të padiferencuar nga baza e të dhënave LC/NAF nuk e shkarkoni, mirëpo krijoni një regjistrim të ri për emrin vetjak të diferencuar (kodi "a" – *emër vetjak i diferencuar* në nënfushën 120b).

Pikëqasja e njësuar (fusha 2XX)

Pikëqasjen e njësuar pas konvertimit duhet ta redaktoni në përputhje me rregullat e vlefshme të katalogimit në sistemin COBISS.AL.

Nëse në regjistrimin për emrin vetjak në formatin MARC 21 përveç formës së emrit me inicialet apo shkurtesat në nënfushën 100a ekziston edhe forma e zgjeruar e emrit në nënfushën 100q, pas konvertimit në harmoni me rregullat tona transferohet forma e emrit në nënfushën 200b si pikëqasje e njësuar, ndërsa forma e shkurtër e emrit në fushën 400 si variant i pikëqasjes.

Pas konvertimit në nënfushën 200f shpesh frazat në mënyrë automatike përkthehen në gjuhën e katalogimit (në gjuhën shqipe), ndërsa të tjerat duhet t'i përkthej kataloguesi. Gjithashtu duhet të përkthehen shtesat tek emri në nënfushën 200c – *Shtesa të emrit (jo datat)*, të cilat pas transferimit mbeten në gjuhën angleze (p.sh. pikëqasja e njësuar *Leonard, Michael, Anesthesiologist* ndryshohet në *Leonard, Michael, anesteziolog*).

Te shkarkimi i regjistrimit për emrat e organizatave apo mbledhjeve duhet të keni kujdes në rregullat e katalogimit dhe rregullat në formatin COMARC/A. Në bazën e të dhënave LC/NAF cilësorët janë në gjuhën angleze (p.sh. *Musical group; Brussels, Belgium* etj.), emrit gjeografik i shtohet edhe hapësira e gjerë, do me thënë përkrah vendit është edhe shteti (p.sh. *Vienna, Austria*), numrin i mbledhjes në formën që përdoret sipas rregullave të drejtshkrimit të gjuhës angleze (p.sh. *5th*) etj. Sipas rregullave tona cilësorët shënohen në shqip (p.sh. *grupi muzikor; Bruksel; Belgjikë*).

¹² Për emrin e vetjak të padiferencuar shih Katalogimi në sistemin COBISS – përditësimi CONOR, Maribor, IZUM.

¹³ Të tilla janë p.sh. shënimet që tregojnë se pikëqasjet e njësuar në bazën e të dhënave LC/NAF nuk do të përdoren në kuadër të rregullave RDA, derisa regjistrimi të mos redaktohet në përputhje me udhëzimet DCM z1 008/32 (p.sh. *This 1XX field cannot be used under RDA until this undifferentiated record has been handled following the guidelines in DCM z1 008/32* etj.). Për shkak se këto shënime nuk janë relevante për ju i fshini ato.

etj.), emrit të vendit ose emrit të hapësirës gjeografike nuk i shtohet hapësira e gjerë (p.sh. *Vjenë*), numri i mbledhjes vendoset me numër arab (p.sh. 5) etj.

Në regjistrimet e shkarkuara nga baza e të dhënave LC/NAF duhet të shtoni fushën 810 me burimin në të cilin keni gjetur të dhënë për pikëqasjen e njësuar. Nëse në COBIB ekziston burimi për formën e njësuar të emrit, atë e vendosni në fushën 810. Në rast të kundërt si burim në fushën 810 e vendosni bazën e të dhënave LC/NAF ose ndonjë burim tjetër referues. Në nënfushën 810a vendoset emri i bazës ose burimit referues, ndërsa në nënfushën 810b shënohet forma e njësuar e emrit, siç është në këtë bazë ose në burimin e përzgjedhur referues (p.sh. emri vetjak në formë të përmbysur me shtesat të emrit: 810__aLC/NAF bBaken, Ronald J., 1943-).

Shënimi informues (fusha 300) dhe shënimi për biografi dhe veprimtari (fusha 340)

Pas konvertimit të tekstit në bllokun 3XX për shënimet publike ruhet në anglisht. Gjatë përmirësimit apo plotësimit të këtyre regjistrimeve disa të dhëna duhet ose të fshihen ose të përkthehen në gjuhën e katalogimit. Përfundim nga kjo rregull janë emrat zyrtar të organizatave, institucioneve etj., të cilat nuk duhet të përkthehen.

Sipas nevojës mund të shtoni edhe shënimet tuaja.

Varianti i pikëqasjes (fusha 4XX)

Gjatë përmirësimit apo plotësimit të varianteve të pikëqasjes respektohen rregullat e vlefshme të katalogimit në COBISS.AL.

Nëse në variantet e pikëqasjeve për emrin vetjak në nënfushën 400f apo 400c transferohen shtesat të emrit, verifikoni nëse në bazën e të dhënave CONOR.AL dhe në COBIB ekzistojnë persona me të njëjtin emër. Nëse ata ndodhen në bazë, shtesat të emrit në nënfushën 400f apo 400c nuk i fshini (në nënfushën 400c shtesën tek emri e përktheni në gjuhën e katalogimit), në rastin e kundërt shtesat tek emri i fshini.

Në regjistrimet e shkarkuara nga baza e të dhënave LC/NAF duhet të shtoni fushën 810 me burimin, në të cilin keni gjetur të dhënë për variantin e pikëqasjes. Fillimisht duhet të verifikoni nëse format e emrit, të cilat nga baza e të dhënave LC/NAF janë transferuar në fushat 4XX, ekzistojnë në COBIB. Përmes të gjitha formave të mundshme të emrit kërkoni regjistrimet bibliografike për veprat që janë të lidhura me entitetin. Nëse burimin për formën e emrit në fushën 4XX në COBIB nuk e gjeni, këtë variant të pikëqasjes nga fusha 4XX duhet ta fshini. Përfundim përmbajnë rastet kur sipas rregullave variantet e pikëqasjeve duhet të vendosen edhe kur burimi me atë formë të emrit nuk ekziston. Këto janë format e emrit të organizatave me numër të zgjeruar në emër, me numër arab në emër, me nyje në fillim të emrit ose me simbolin e zgjeruar "&" në emër etj.

Kontrolloni nëse në COBIB ekziston edhe ndonjë formë e emrit që nuk është transferuar nga baza e të dhënave LC/NAF. Nëse gjeni ndonjë regjistrim bibliografik me formë të tillë të emrit, e shtoni fushën 4XX me variantin e pikëqasjes dhe fushën 810 me burimin për këtë formë të emrit.

Pikëqasja në lidhshmëri – emër vetjak (fusha 500)

Sipas rregullave të vlefshme të katalogimit për një person bëhet vetëm një regjistrim i njësuar, edhe nëse ky person në botimet e tij përdor emra të ndryshëm. Për variantet e tjera të emrit krijohen variantet e pikëqasjes.

Te autorët e huaj mund të përdoren rregullat anglo-amerikane, sipas të cilave për një person mund të bëhen disa regjistrime të njësuar, kur ky person përdor emra të ndryshëm në fusha të ndryshme të krijimtarisë (p.sh. në romanet moderne për dashurinë përdor emrin e vërtetë, ndërsa në romanet historike për dashurinë përdor pseudonimin). Disa regjistrime krijohen edhe kur personi ose disa persona përdorin një pseudonim të përbashkët, në anën tjetër botojnë edhe vepra të pavarura me emrat e tyre. Disa regjistrime të njësuar për një person mes vete lidhen përmes fushës 500. Fusha 500 përmban pikëqasjen për formën e njësuar të emrit vetjak, që është në lidhshmëri¹⁴ me pikëqasjen në fushën 2XX.

Nëse përmes konvertimit transferohet edhe fusha 500, atë e redaktoni në përputhje me udhëzimet ose emrin vetjak nga fusha 500 e transferoni si variant të pikëqasjes në fushën 400.

Pikëqasja në lidhshmëri – emër organizate (fusha 510)

Nëse përmes konvertimit transferohet fusha 510 me emrin e organizatës si pikëqasje në lidhshmëri, verifikoni në bazën e të dhënave CONOR.AL a ekziston regjistrimi për këtë formë të emrit që është në fushën 510. Nëse regjistrimi ekziston numrin e tij identifikues e shënoni në nënfushën 5103.

Nëse në bazën e të dhënave CONOR.AL nuk ndodhet regjistrimi për formën e emrit që është në fushën 510 të regjistrimit të shkarkuar, verifikoni nëse në COBIB ekzistojnë regjistrime bibliografike të autorit që ka këtë formë të emrit. Nëse regjistrimet ekzistojnë, krijoni një regjistrim të ri për këtë formë të emrit dhe atë lidheni me regjistrimet bibliografike dhe më pas numrin identifikues të regjistrimit të njësuar shënojeni në nënfushën 5103.

Nëse në bazën e të dhënave CONOR.AL dhe në COBIB nuk ndodhet forma e emrit që është në fushën 510 të regjistrimit të shkarkuar, fusha 510 fshihet.

E dhëna është në (fusha 810)

Në regjistrimet e shkarkuara nga baza e të dhënave LC/NAF duhet të shtoni fushën 810, në të cilën vendoset burimi për formën e emrit nga i cili është krijuar pikëqasja e njësuar (fusha 2XX) ose varianti i pikëqasjes (fusha 4XX).

Të dhënat për burimin në nënfushën 810a vendosen edhe në mënyrë automatike. Këto të dhëna në formën e të dhënave bibliografike transferohen në mënyrë automatike nga regjistrimi në COBIB ose nga regjistrimi në redaktues (shih *Udhëzime për përdorimin e aplikacionit COBISS Cat*, kap. *Të dhënat për burimin (810a)*).

¹⁴ Për pikëqasjet në lidhshmëri shiko Katalogimi në sistemin COBISS – përditësimi CONOR, Maribor, IZUM.

E dhëna nuk është në (fusha 815)

Nëse fusha 815 pas konvertimit ka shënimin për burimet e kontrolluara, në të cilat kataloguesi nuk e ka gjetur të dhënë për pikëqasjen, kataloguesi vendos nëse ky shënim është i rëndësishëm.

Nëse shënimi i transferuar është i rëndësishëm për ju, atë e mbani, në të kundërtën e fshini.

Sipas nevojës shtoni edhe burimet tuaja që i keni kontrolluar, mirëpo në to nuk keni gjetur të dhënat për entitetin.

Shënime të përgjithshme të kataloguesit (fusha 830)

Nëse fusha 830 pas konvertimit është e plotësuar me shënimin e përgjithshëm të kataloguesit, kataloguesi vendos nëse ky shënim është i rëndësishëm.

Nëse shënimi i transferuar në gjuhën angleze është i rëndësishëm për ju, tekstin e shënimit e përktheni, në rast të kundërt e fshini atë (p.sh. shënimi *Formerly on undifferentiated name record: n 88175987* fshihet).

Sipas nevojës mund të vendosni shënimin tuaj.